



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 221 Prot.,

Vlorë, më 08.01.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2025

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË GRANTIT TË MENJËHERSHËM NGA BUXHETI I SHTETIT FAMILJES SË Z.AGIM SELFO MEÇANAJ, E TRAJTUAR ME BANESË ME KOSTO TË ULËT ME VKB NR.6, DATË 29.01.2024

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 1 dhe 2, neni 24 pika 1, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social” neni 45 dhe 46, të VKM Nr.555 datë 15.07.2020 “Për procedurat dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit”, të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.6, datë 29.01.2024 2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen “Kushtrimi” tek ish-frigoriferi Vlorë”, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë,

VENDOSI

- I. Të miratojë dhënien e grantit të menjëhershëm nga buxheti i shtetit familjes së z. Agim Selfo Meçanaj, e trajtuar me banesë me kosto të ulët me VKB Nr.6, datë 29.01.2024.
- II. Të miratojë kërkesën drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për akordimin e grantit të menjëhershëm ndaj familjes Agim Meçanaj në masën 10% të çmimit të shitjes së apartamentit nga Enti Kombëtar i Banesave. 10% e çmimit të shitjes së apartamentit në vlerën 2 969 244 lekë =296 924,4 lekë.
- III. Efektet financiare sipas pikës 1 dhe 2 do të mbulohen nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit në fondet për programet e strehimit social të-vitit-2025.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës & Investimeve Publike dhe Enti Kombëtar i Banesave Vlorë.
- V. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR
Ermal Dredha

Me urdhër dhe delegim

N/KRYETARE

Irena Toshkallari





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

RELACION

Mbi projekt-vendimin

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË GRANTIT TË MENJËHERSHËM NGA BUXHETI I SHTETIT FAMILJES SË Z.AGIM SELFO MEÇANAJ , E TRAJTUAR ME BANESË ME KOSTO TË ULËT ME VKB NR.6, DATË 29.01.2024

Me shkresën e regjistruar pranë Bashkisë Vlorë me Nr.18114Prot., datë 07.11.2024 “ Dorëzim dokumentacioni për të përfituar grantin e menjëhershëm”, z. Agim Meçanaj ka aplikuar pranë Bashkisë Vlorë për të përfituar grantin e menjëhershëm nga fondet e buxhetit të shtetit në programet për strehimin social për vitin 2025, nëpërmjet ministrisë që mbulon çështjet e strehimit.

Në zbatim të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar dhe të VKM Nr.555, datë 15.07.2020 “Për procedurat dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesa me kosto të ulët nga buxheti i shtetit” përfitojnë grant të menjëhershëm me përparësi:

1. Kryefamiljarët me aftësi të kufizuara
2. Familjet me më shumë se një person me aftësi të kufizuara
3. Individët me statusin e jetimit, i cili jeton në banesa të papërshtatshme, ose konvikte
4. Kryefamiljarët e vetëm, viktimë e dhunës në familje
5. Familjet njëprindërore të minoritetit rom dhe egjiptian
6. Familjet/individët që kanë rënë në vështirësi financiare dhe rrezikojnë të humbasin banesën me kosto të ulët që kanë blerë me kushte kreditimi

Sipas përcaktimit ligjor granti i menjëhershëm është një instrument financiar që përdoret për lehtësimin e blerjes së banesës me kosto të ulët nga përfituesi në rastet e sipërpërmendura dhe është në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët.

Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë i mbledhur në datën 07.01.2025 mori në shqyrtim kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga familja Agim Meçanaj për të përfituar grantin e menjëhershëm, si edhe dokumentacionin shkresor të përcjellë nga EKB për këtë rast. U konstatua se, me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.6, datë 29.01.2024 2024 “Për miratimin e listës së familjeve dhe individëve, që përfitojnë banesë me kosto të ulët në apartamentet e ndërtruara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen “Kushtrimi” tek ish-frigoriferi Vlorë” familja e z. Agim Selfo Meçanaj është trajtuar me strehim në apartament me strukturë 2+1, objekti nr.2, kati i pestë. Aktualisht kjo familje, që është edhe anëtare e komunitetit egjiptian, përbëhet nga gjashtë persona ku;

- dy persona janë në marrëdhënie pune me pagë mujore neto 35520 lekë në muaj dhe 60283 lekë në muaj
- një person është kujdestar i personit me aftësi të kufizuara
- tre persona janë individë me aftësi të kufizuara, ose me aftësi ndryshe.

Për të përfituar grantin e menjëhershëm si familje me tre anëtarë me aftësi të kufizuara familja Meçanaj ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me përcaktimet ligjore si vijon:

1. Kopje të kontratës së shitblerjes së banesës me kosto të ulët, të lidhur me Entin Kombëtar të Banesave, dërguar nga EKB me shkresën Nr.293Prot., datë 27.12.2024 dhe të regjistruar pranë Bashkisë Vloreë me shkresën Nr.20861Prot., datë 30.12.2024.
1. Dokumentin e lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave, që nuk kanë përfituar zbritje të vlerës së banesës për shkak të statusit të familjes, të regjistruar pranë Bashkisë Vlorë me Nr.20861Prot., datë 30.12.2024
2. Çdo dokument tjetër të përcaktuar me VKM Nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Vlera e apartamentit të përfituar nga familja Meçanaj, sipas shkresës së sipërcituar të dërguar nga Enti Kombëtar i Banesave është = 2 969 244 lekë, që duhet të shlyhet me këste mujor prej 20.505 lekë për 15 vjet me interes 3%.

I kërkojmë Këshillit të Bashkisë, që të miratojë dhënien e grantit të menjëhershëm për këtë familje në masën 10% të çmimit të shitjes së banesës me kosto të ulët. Kjo shumë do të përfitohet falas nga familja dhe do të akordohet nga fondet për strehimin të MEK&I për vitin 2025. Këshilli i Bashkisë do të miratojë edhe kërkesën për dhënien e grantit të menjëhershëm drejtuar MF&E. Sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë, miratimin e këtij projekt vendimi për të ndihmuar familjen Agim Meçanaj, familje e komunitetit egjiptian, që të përfitojë nga kushtet lehtësuese të përcaktuara me ligj, si familje në përbërjen e së cilës jetojnë tre anëtarë me aftësi ndryshe dhe nuk ka përfituar ulje të vlerës së apartamentit nga Enti Kombëtar i Banesave.

Drejtori i DI&IP
Zambak Selmani

Specialiste e Strehimit
Drita Mustafai